



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Personat t Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr.16
Prishtinë, më 17. 7. 2008, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Personat të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi, Shpresa Murati, Naim Rrustemi dhe Vezira Emrush – anëtarë.

Mungoi: Radmila Vujović, që ishte në udhëtim zyrtar jashtë Kosovës.

Të ftuar:

- Shqipe Krasniqi - ushtruese e detyrës së kryeshefit të Agjencisë për Barazi Gjinore,
- Leonaora Selmani - zyrtare për legjislacion në ABGJ,
- Nexhat Shatri nga Presidenca e Republikës së Kosovës dhe Rrahim Demaj e Sulltane Gashi nga stafi mbështetës i Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi Ismet Beqiri, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky

R e n d d i t e

- 1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, mbajtur më 8. 7. 2008,
- 2 Shqyrtimi i nevojës eventuale për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për barazi gjinore,
- 3 Kërkesë Kryesisë së Kuvendit të Kosovës për lejimin e një vizite studimore jashtë Kosovës,
- 4 Shqyrtimi i peticioneve,
- 5 Të ndryshme

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Kryesuesi - Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, mbajtur më 8. 7. 2008

Kryetari - Konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes kaluar.

2. Shqyrtimi i nevojës eventuale për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për barazi gjinore

Kryetari - Theksoi se për këtë pikë e kemi ftuar ushtruesen e kryeshefit të ABGJ-së znj. Shqipe Krasniqi që në pika të shkurta t'i informojë anëtarët e Komisionin lidhur me nevojën eventuale për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për barazi gjinore. Ai e falënderoi që iu ka përgjigjur ftesës dhe e ftoi ta marrë fjalën.

Shqipe Krasniqi – Në pika të shkurta e njoftoi Komisionin për nevojën eventuale për plotësimin e Ligjit për barazi gjinore që i promovon vlerat dhe mundësitë e barabarta pa marrë parasysh përkatësinë gjinore. ABGJ-ja ka vërejtur se gjatë zbatimit të ligjit në praktikë ka hasur shumë vështirësi, për shkak të vakumit legjislativ, që nuk janë identifikuar në kohën e hartimit. Ajo kërkoi që emërtimi “Zyra për Barazi Gjinore” të zëvendësohet me emërtimin: ”Agjencia për Barazi Gjinore”. Arsyetimin për zëvendësim e bazoi në vendimin e Qeverisë së Kosovës me të cilin e ka themeluar agjencinë përkatës. Mirëpo, në vazhdim në mënyrë kronologjike ua paraqiti vërejtjet që kanë të bëjnë me ligjin si vijon:

Nenit 5.2(0) të ligjit ku theksohet: “Zyra për Barazi Gjinore, gjatë kryerjes se detyrave të saj të theksuara në nenin 5.2 (a) deri të (n), i bashkërendoj aktivitetet me Zyrën këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë, për të drejtat e njeriut, për mundësi të barabarta”. Ajo sugjeron që shtojca të hiqet nga ligji. Arsyetimin për heqjen e shtojcës se ligjit e bazoj në faktin se ka përzierje të kompetencave ndërmjet dy zyrave, pra: Zyrës për Barazi Gjinore dhe Zyrës për Qeverisje të Mirë.

Në nenin 4.12 sugjeron që togfjalëshi “zyrtar për barazi gjinore” të zëvendësohet me fjalën “koordinatore”, që i raporton ABGJ-së për zbatimin e plotikave të barazisë gjinore. Pra, fushëveprimi i saj do të rregullohet me akt nënligjor dhe konform nenit 4.9 të Ligjit për barazi gjinore. Qeveria e formon këshillin ndërministror, anëtar i të cilit janë zyrtarët për barazi gjinore, mirëpo rekomandon që gjatë planifikimit të buxhetit kalendarik të përfshihet edhe buxheti gjinor.

Në nenin 4.15 të ligjit të lartpërmendur theksohet “kërkohet që organet e qeverisjes lokale të zgjedhin koordinatorë për barazi gjinore në komuna dhe detyrat e tyre të përcaktohen me akt nënligjor”.

Në nenin 4.17 të ligjit të lartpërmendur të hiqet fjala “zyrtar” për barazi gjinore dhe të zëvendësohet me fjalën “koordinatorja” për barazi gjinore. Ajo e mbeshti idenë se ligji për barazi gjinore i obligon organet e qeverisjes lokale t'i themelojnë zyrat për barazi gjinore në komuna. P.sh. komuna e Drenasit dhe Skenderaj e kanë respektuar, ndërsa të tjerat jo. Gjithashtu, e shtroi nevojën e qartësisht të pozicionit të Agjencisë në raport me Zyrën e Kryeministrit.

Nenit 5.2 (1) të ligjit të lartpërmendur kërkon t'i shtohet një paragraf i ri : “ndërmerr nisma për hulumtime, studime dhe analiza në fushën e barazisë gjinore”.

Nenit 9 kërkohet t'i shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje: ”Institucionet e Kosovës të përcaktuara në paragrafin 9.3 janë të obliguara t'i raportojnë ABGJ-së. Arsyetimin e bazoj se gjatë grumbullimit të të dhënave kam hasur në vështirësi për sigurimin e tyre.

Ismet Beqiri - E falënderoi duke i çmuar lart vërejtjet, prandaj Komisioni do ta mbajë një tryezë të rrumbullakët, në të cilën do të ftohen ABGJ-ja, OJQ-të dhe Shoqëria civile, me temën për vështirësitë me të cilat po ballafaqohemi gjatë zbatimit në praktik të Ligjit për barazi gjinore. Ceku se në këtë drejtim edhe nga OSB-ja kemi ofertë për mbështetje legjislative.

Sanije Alijaj - Duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësës kërkoi të ftohet një numër më i madh i subjekteve që merren me këtë fushë pa e përjashtuar grupin joformal të deputetëve. Ishte konstatim i përgjithshëm se ka nevojë për plotësimin e ligjit në fjalë dhe kjo do të bëhet, pas pushimeve verore, për organizimin e tryezës.

3 Kërkesë Kryesisë se Kuvendit të Kosovës, për lejimin e një vizite studimore jashtë Kosovës

Kryetari – E vuri në pah se Komisioni duhet ta bëjë një vizitë studimore jashtë Kosovës dhe të njihet me komisionet homologe të parlamenteve evropiane. Ai ishte i mendimit që së pari të vizitohet Republika e Shqipërisë, pasi ka një demokraci më të zhvilluar. Sa u përket personave të pagjetur në Bosnje-Hercegovinë kemi pika të përbashkëta dhe kërkohet ta realizojmë. Me propozimin e tij u pajtuan anëtarët e Komisionit, prandaj Komisioni lidhur me këtë pikë e nxori këtë :

P ë r f u n d i m

1. Komisioni vendosi t'i drejtohet me kërkesë Kryesisë së Kuvendit të Kosovës për lejimin e vizitës studimore në Republikës e Shqipërisë.
2. Realizimi i saj do të bëhet gjatë muajit shtator 2008.

4 Shqyrtimi i peticioneve

Prof dr. Nerxhivane Dauti – E vuri në pah se e ka shqyrtua shkresën e prof. Muhamet Shalës, me të cilën kërkon të rishqyrtohet vendimi për largimin e tij nga banesa nga ana e HABITA-tit dhe njëkohësisht kërkon trajtim të barabartë me kolegët e tij lidhur me ndarjen e trojeve që ishin në shfrytëzim të UP-së.

Pas diskutimeve që u zhvilluan nga disa anëtar të Komisionit në lidhje me shkresën e prof Muhamet Shalës ,Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Komisioni vendosi që gjatë shqyrtimit të këtij peticioni të ftohen :

1. Z. Muhamet Shala parashtrues i peticionit ,
 2. Rektori i UP, ose përfaqësuesi i tij,
 3. Kryetar i Komunës se Prishtinës ose përfaqësuesi i tij
- Datën e mbajtjes se mbledhjes do të caktoi në shtator 2008

5 Ndryshme

Komisioni i shqyrtoi programin e punës dhe detyrat që e presin pas pushimeve verore.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

Përgatitur nga
Rrahim Demaj, zyrtar i lartë ligjor

Kryesuesi i Komisionit
Ismet Beqiri